



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:108546

Datë: 13.10.2020

Numri i dokumentit: 01185180

PKR.nr.95/20

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti për Krime të Rënda, përmes kryetarit të trupit gjykues Islam Thaçi, me zyrtaren ligjore Zahide Rexhepi, procesmbajtëse, në çështijen penale, kundër të pandehurit L. H, për shkak të veprës penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së PTHDKR, PP.I. nr. 101/2020, të dt.30.09.2020, të cilën e përfaqësonte prokurori i shtetit Arben Kadriu, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik më datë 30.09.2020, shpalli publikisht , ndërsa më 13.10.2020, hartoi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri L. H, nga babai B.dhe nëna E. , e lindur S., i lindur medaten ... në Gjilan, me vendbanim ne Viti, ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar, i martuar ,babai i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i R. së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 25 Gusht 2020, rreth orës 23:35 minuta, në Viti, pa autorizim dhe pa leje valide në kundërshtim të ligjit të zbatueshëm për armët, ka mbajtur në pronsi armën e zjarrët të llojit TT 7, 62 mm M57, me numer serik..., si dhe 4 fishekë të kalibrit 7,62 mm, të cilat i janë sekuestruar nga ana e policisë së Kosovës.

Me çka ka kryer veprën penale, mbajtja në pronësi , kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366 par.1 i KPRK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitën e sipërtheksuar ligjore si dhe neneve: 4, 7, 17, 38, 39, 40, 43, 44, 69,76, 70,71, dhe 72 të KPRK-ës, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, të pandehurin, e

G J Y K O N

Për veprën penale dispozitiv I, dënim me gjobë në shumën prej 500€ (pesëqind) Euro,
Për veprën penale dispozitivi II, dënim me burgim më kohëzgjatje prej 90 ditëve, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit i zavendësohet në dënim me gjobë në shumën prej 1000€ (njëmijë) Euro.

Gjykata duke vepruar në kuptim të nenit 76 paragrafi 1 nënparagrfi 2.4 të KPRK-së, të pandehurin e gjykon me dënim unik me gjobë në shumën prej 1500€ (njëmijë e pesqind) Euro, të cilën do ta paguaj në afat prej tre (3) muajve , pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

Pagesa, duhet të bëhet në tre këste të barabarta, duke përpjestuar shumën si më lartë , edhe ate brenda javës së parë të muajve në vijim.

Nëse i pandehuri nuk mundet apo nuk dëshiron që t'a paguaj dënimin me gjobë në shumën si më lartë, atëher të njëjtit gjykata, dënimin me gjobë, do t'ia zavendësoj në dënim me burgim, duke llogaritur një ditë burgim me 20€ gjobë.

Detyrohet i pandehuri që të paguaj paushallin gjygjësor në shumën prej 20€, si dhe shumën prej 50€, në emer të taksës për kompensimin e viktimave të krimit.

Të pandehurit, i konfiskohet arma e zjarrtë e llojit TT 7,62 mm M57, me numer serik CI 2301470, si dhe 4 fishekë të kalibrit 7,62 mm.

A r s y e t i m

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjiilan, Departamenti i për Krime të Rënda, pranë kësaj gjykate me datë 10.09.2020, ka paraqitur aktakuzën, PP.I. nr. 235/ 19, të dt. 09.09.2020, kundër të pandehurit L. H, për shkak të veprave penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 30.09.2020, në të cilën kanë prezentuar: Prokurori i Shtetit Arben Kadriu, si dhe i pandehuri L. H.,

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, i pandehuri L. H, ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprat penale për të cilat akuzohet, duke e pranuar fajësinë për kryerjen e veprave penale për të cilat akuzohet, andaj, kryetari i trupit gjykues pasi konstatoi se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për pranimin e fajësisë në pajtim me nenin 248 par.1 nën para. 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të KPRK-së, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar fajësinë nga ana e të akuzuarit.

2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Kryetari i trupit gjykues ka konstatuar se i pandehuri L. H, e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranoj fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, kryetari i trupit gjykues vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri L. H, në kohën dhe vendin e përshkruar si në dispozitivat e aktakuzës, ka kryer veprat penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, dhe përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 paragraf 1 i KPRK-së, për çka është edhe penalisht përgjegjës dhe fajtor.

4.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Kryetari i trupit gjykues, me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit është mbështetur në nenet: 69,71, dhe 72 të KPRK-ës, me ç'rast të pandehurin L. H, e ka shpallur fajtor, edhe atë për veprat penale të përshkruar si në dispozitivin 1 të aktakuzës, dënim me gjobë në shumën prej 500€ (pesëqind) Euro, ndërsa për veprat penale të përshkruar si në dispozitivin 2 të aktakuzës, dënim me burgim në kohëzgjatë prej 90 ditëve, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit dhe në kuptim të nenit 44 të KPRK-së i zavendsohet në dënim me gjobë në shumën prej 1000€ (njëmijë)Euro.

Gjykata duke vepruar në kuptim të nenit 76 paragrafi 1 nenparagafi 2.4 të KPRK-së,të pandehurin e gjykon me dënim me gjobë në shumën prej 1500€ (njëmijëepesqindë)Euro, të cilin do ta paguaj në afat prej tre (3) muajve, pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

Pagesa, duhet të bëhet në tre këste të barabarta, duke përpjestuar shumën si më lartë, edhe atë brenda javës së parë të muajve në vijim.

Nëse i pandehuri nuk mundet apo nuk dëshiron që ta paguaj dënimin me gjobë në shumën si më lartë, atëher të njëjtit gjykata, dënimin me gjobë, do t'ia zavendësoj në dënim me burgim, duke llogaritur një ditë burgim me 20€ gjobë.

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë faktin se i pandehuri L. H, e ka pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohet, se i njëjti është penduar, se i njëjti për herë të parë ka ra ndesh me ligjin, se i pandehuri ka bashkëpunuar me organet e drejtësisë, si dhe faktin se i pandehuri ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të këtilla apo të ngjashme penale.

5.Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së kryetarit të trupit gjykues dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit, duke i marrë parasysh rrethanat e lartpërmendura është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprave penale, me mënyrën e kryerjes së veprave penale si dhe shkallën e përgjegjësisë penale së të pandehurit.

Kryetari i trupit gjykues po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprat penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale, kryetari i trupit gjykues duke u bazuar në nenin 453 paragrafi 1 e lidhur me nenin 450 paragrafi 1 dhe 2 nënparagrafi 2.6 të KPP-së, ka vendosur që të pandehurin t'a detyrojë që të paguaj paushallin gjygjësor në shumën prej 20€ si dhe shumën prej 50€, në emër të taksës për kompenzimin e viktimave të krimit.

Gjykata duke vepruar në kuptim të nenit 115 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 të KPPRK-së , e në lidhje me nenin 366 paragrafi 3 të KPRK-së, të pandehurit i konfiskohet arma e zjarrtë e llojit TT 7,62 mm M57, me numer serik CI 2301470, si dhe 4 fishek të kalibrit 7,62 mm, e cila do të shkatërrohet –asëgjësohet, komform dispozitave të ligjit në fuqi.

Më sa u tha më sipër u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Themelore në Gjiilan - Departamenti për Krime të Rënda

PKR.nr.228/ 2019, më 27.02.2020.

**Zyrtare ligjore,
Zahide Rexhepi, d.v.**

**Kryetari i trupit gjykues
Islam Thaçi, d.v**

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.